

PËRSE PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA DUHET TË JENË PRIORITET PËR VAKSINIMIN NDAJ COVID-19?

Shtetet duhet të marrin vendime për grupet që duhet të kenë përparësi në vaksinat COVID-19, në mënyrë që të shpëtohen sa më shumë jetë të jetë e mundur.




Këto vendime duhet të bazohen në dy kritere:
Për të mbrojtur grupet dhe individët më të rrezikuar;
Për të ngadalësuar dhe përfundimisht ndaluar përhapjen e sëmundjes.



Personat me aftësi të kufizuara përbëjnë rreth 15% të çdo popullsie. Për shkak të aftësisë së kufizuar të tyre, ata janë më të rrezikuar nga COVID-19.

ARSYET PSE ATA JANË MË TË RREZIKUAR NGA COVID-19 PËRFSHIJNË:



Disa persona me aftësi të kufizuara...
Kryejnë aktivitetet e tyre të përditshme me një ndihmës personal, interpret ose persona të tjerë mbështetës - prandaj distancimi fizik nuk është i mundur ose është shumë i kufizuar.



Janë të detyruar të jetojnë në ambiente të përbashkëta ku mundësitë e infektimit janë shumë të larta (institucione, spitale psikiatrike, kampe refugjatësh)



- Mund të kenë rrethana shëndetësore ekzistuese ose të jenë në moshë të thyer që i vendosin në rrezik më të madh infektimi nga Covid-19
- Mund të kenë rrethana të tjera shëndetësore që kërkojnë më shumë akses në shërbimet shëndetësore dhe për këtë arsye ndodhen në vende publike që krijojnë rrezik infektimi.



Përballen me diskriminim në aksesin në kujdesin shëndetësor dhe trajtime.



Easy read



Large print



BSL



Braille



Email or
SMS text



Other
communication
support

Nuk marrin këshilla për shëndetin publik në një formë të përshatur.



Jetojnë në varfëri dhe kjo rrit të gjitha rreziqet që lidhen me shëndetin, përfshirë COVID-19.



I përkasin grupeve të tjera të marginalizuara dhe kjo rrit diskriminimin dhe rreziqet për t'u infektuar nga COVID-19- për shembull gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, romët me aftësi të kufizuara, refugjatët me aftësi të kufizuara kanë qenë në një rrezik më të lartë të infektimit dhe vdekjes nga COVID-19.

Ky dokument është përgatitur nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara në kuadrin e projektit “ COVID-19, Reagim Përfshirës për Aftësinë e Kufizuar”, të mbështetur financiarisht nga Ballkan Trust for Democracy(BTD). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e BTD.

Për të marrë informacione të mëtejshme në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe Covid-19, ju mund të lexoni materialet e publikuara në faqen tonë: <https://platforma-pak.al/te-drejtat-e-personave-me-aftesi-te-kufizuara-dhe-covid-19/>, ku keni dhe hapësirën e posaçme dedikuar për pyetjet tuaja.